



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:019615
Datë: 24.01.2024
Numri i dokumentit: 05231589

AA.nr.195/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit V... R., Gj..., fs... K..., Komuna e Kamenicës, përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve RPHS Law, në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës, përfaqësuar nga avokat I... R..., me palë të interesit Q... K..., nga Kamenica, përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve RPHS Law, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditues, Komuna e Kamenicës, përfaqësuar nga avokat I... R..., kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative, A.nr.202/2022, të datës 09.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 09.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Kamenicës, përfaqësuar nga avokat I... R... nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.202/2022, i datës 09.02.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.202/2022, të datës 09.02.2023, në pikën I të dispozitivit është ndërprere procedura në këtë çështje të konfliktit administrativ sipas padisë së datës 01.02.2022 lënda A.nr.202/2022, deri në vendosjen me vendim gjyqësor në konfliktin administrativ sipas lëndës A.nr.1765/20. Ndërsa në pikën II. të dispozitivit është vendosur që procedura e ndërprere do të vazhdoj sipas propozimit të palëve, pasi të kenë pushuar shkaqet e ndërprerjes si në pikën I të dispozitivit.

Kundër aktvendimit të lartcekur, ka ushtruar ankesë përfaqësuesi me autorizim i të paditurës Komuna e Kamenicës, avokat I. R..., nga Prishtina për shkak të: shkeljeve të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Kamenicës, përfaqësuar nga avokat I... R... dhe të anulohet aktvendimi i ankimuar si i kundërligjshëm, ose çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në shkallë të parë apo të ndryshohet ashtu që të pezullohet aktvendimi A.nr.202/2022, i datës 21.03.2023 me të cilin ka shtyre ekzekutimin e vendimit nr.390 të dt.29.12.2021.

Përgjigje në ankesë në afat ligjor ka paraqitur përfaqësuesja e autorizuar e paditësit Shoqëria e Avokatëve RPHS Law, në Prishtinë, me propozim që ankesat e të paditurës të refuzohen si te pa bazuara, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.202/2022, i datës 09.02.2023, të vërtetohet.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Konfliktin Administrativ (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi V... R..., nga fshati K..., Komuna e Kamenicës, baba i fëmijëve (me të dhënat si në padi), kundër të paditurës Komuna e Kamenicës, me palë të interesit Q... K..., rr. Agim Ramadani, Kamenicë, ka parashtruar padinë e datës 01.02.2022, duke kërkuar anulimin e vendimit të të paditurës nr.390 datë 29.12.2021

Gjykata, e shkallës së parë me qëllim të vërtetimit të kësaj çështje, ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me datë 09.02.2023 dhe referuar deklaratën të palëve dhe shkresave të lëndës ka konstatuar se pranë kësaj Gjykatë është duke u zhvilluar konflikti administrativ sipas padisë A.nr.1765/20 të datës 23.10.2020, për anulimin e vendimit nr.1987 datë 10.09.2020, lidhur me të cilën padi nuk është vendosur ende me vendim gjyqësor.

Gjykata e shkallës së parë pasi që mori dhe vlerësoi të dhënat e cekura si më lartë, e duke marrë në konsideratë faktin se me vendimin e atakuar me padi objekt shqyrtimi sipas lëndës A.nr.202/2022 në pikën dy të të njëjtit shfuqizohen pikat nga vendimi *Sh.02 nr.19870 datë 10.09.2020* dhe atë pika 1 paragrafi 1.1, pika 2 paragrafi 2.1, pika 3 paragrafi 3.1, pika 4 paragrafi 4.1 dhe mbetet në fuqi pjesa tjetër e vendimit *SH.02.Nr.19870 datë 10.09.2020*.

Duke pasur parasysh se në konflikt administrativ është duke u zhvilluar procesi gjyqësor lidhur me anulimin e vendimit të datës 10.09.2020, kurse në lëndën A.nr.202/2022 kërkohet anulimi i vendimit i cili ka shfuqizuar pikat e vendimit të datës 10.09.2020, në këtë kuptim përderisa ende me vendim gjyqësor nuk është vlerësuar ligjshmëria e vendimit sipas padisë me nr. lënde A.nr.1765/20, Gjykata e shkallës së parë me qëllim të vendosjes së çështjes dhe duke pasur parasysh se është konstatuar një çështje paraprake ka ndërprerë procedurën deri në nxjerrjen e vendimit në kuptim të nenit 32 të LKA-së ku përcaktohet se: "Kur vendimi i gjykatës në konfliktin administrativ varet nga çështja juridike e cila përbënë tërësi të mvetësishme juridike, e mbi të cilën gjykata tjetër ose organi tjetër nuk ka vendosur (çështja paraprake), gjykata që zhvillon konfliktin administrativ, mund ta vendos atë çështje, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe; ose mund ta ndërpresë procedurën deri në nxjerrjen e vendimit mbi çështjen paraprake, nga ana e organit kompetent.

Gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 63 të LKA-së mori parasysh edhe nenin 277 Ndërprerja e gjykimit dhe pushimi i gjykimit, pika (a) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore ku përcaktohet: "Procesi gjyqësor ndërpritet: f)kur ndërprerja e gjykimit parashihet me ndonjë ligj". Për të vendosur si në pikën dy të dispozitivit Gjykata kishte parasysh nenin 280.4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ku përcaktohet: "Në të gjitha rastet e tjera gjykimi i ndërprerë do të vazhdoj me propozimin e palës pasi të kenë pushuar shkaqet e ndërprerjes". Andaj, duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim të nenit 32 të Ligjit për Konfliktet Administrative lidhur me nenin 277 të LPK-së.

Me dispozitën e nenit 278 par.1 pika a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se “Përveç rasteve të parashikuara me këtë ligj, gjykata ndërpret gjykimin: a) po që se ka vendosur që vetë të mos e zgjidh çështjen paraprake .” Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore të lartcekur, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me të drejtë ka ndërprere procedurën sipas padisë së paditësit në këtë çështje juridiko – administrative.

Kolegji vlerëson të drejtë këtë qëndrim juridik të dhënë në aktvendimin e ankimuar, pasi që është konstatuar se në konflikt administrativ është duke u zhvilluar procesi gjyqësor lidhur me anulimin e vendimit të datës 10.09.2020, kurse në lëndën A.nr.202/2022 kërkohet anulimi i vendimit i cili ka shfuqizuar pikat e vendimit të datës 10.09.2020, në këtë kuptim përderisa ende me vendim gjyqësor nuk është vlerësuar ligjshmëria e vendimit sipas padisë me nr. lënde A.nr.1765/20, Gjykata e shkallës së parë me qëllim të vendosjes së çështjes dhe duke pasur parasysh se është konstatuar një çështje paraprake me të drejtë e ka ndërprerë procedurën deri në nxjerrjen e vendimit në kuptim të nenit 32 të LKA-së. Andaj aktvendimi nga gjykata e shkallës së parë është marr duke respektuar dispozitat ligjore dhe procedurale, konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe me zbatim të drejtë të së drejtës materiale.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, thëniet e ankesës se duke qenë se gjykata e shkallës së parë ka ndërpre këtë procedure deri në një vendim të lëndës paraprake, është dashur që të pezulloj apo anuloj masën lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit sikurse ka ndërprere procedurën A.nr.202/2022. Këtu gjykata ka bere lëshime duke mos e ndërpre procedurën lidhur me efektin e masës duke qene se, kjo mase i shërben kësaj lende dhe si e tille tani për tani nuk duhet të jetë në fuqi apo të ketë efekt juridik, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se këto pretendimet ankimore janë pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e ndërprerjes së procedurës sipas padisë së paditësit, e pasi që me pretendimet ankimore se kjo çështje është në kundërshtim me interesin publik dhe tani me rastin e prolongimit shkakton pasoja dhe probleme të pa arsyeshme, një aktvendim i tillë nuk mundë të vihet në pyetje, andaj ankesa u refuzua si e pa bazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 209 pika b) të LPK-së dhe neni 63 të LKA-së për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AA.nr.195/2023, me datë 09.01.2024

Kryetari i kolegjit
Ramiz Kuqi